21 në shqip, është P75, U001-9244 deri në U001-9306. Të fillojmë
22 në faqen U001-9274. Pra, faqja në shqip është korrekt.

23 PY. Të presim për anglishten.

24 Dëshmitar, a ju kujtohet që javën e shkume jua kemi tregu
25 këtë fletore shënimesh?

1 PË. Po.

2 PY. Por para javës së kalume nuk e kishe pa ndonjëherë?

3 PË. Jo.

4 PY. Po e tregoj këtë faqe thjesht për t'ju orientu, se janë
5 shënime nga 1 korriku 1998.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Sekretar, ju lutem, a mund të
7 kaloni në faqen tjetër për të dy versionet?

8 PY. Aty në të majtë të faqes kemi, thotë diçka që thotë,
9 "Armë", edhe emra. "Armatime", dhe pastaj thotë "Opterusha",
10 edhe "Ejup Kabashi". Është ky i njëjti Ejup Kabashi që ishte
11 komandanti i grupit të UÇK-së aty?

12 PË. Po.

13 PY. Emri mbi të a është i njëjti emër, i njëjti person Hazër
14 Shala që e diskutum, që sapo e diskutum?

15 PË. Po.

16 PY. Të konfirmojmë emrin e vendit, çfarë emri, çfarë fshati
17 është ai që është vënë aty afër?

18 PË. Randobravë.

19 PY. Faleminderit.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, Sekretares të kalojë në
21 faqen tjetër.

22 PY. Në të majtë sipër thotë kështu:

23 "Haxhi Mazreku

24 "- Është një person, një njeri shumë i dyshimtë i cili ka
25 kriju shpërndarjen e fshatit dhe ka kriju në atë mënyrë që i

1 ka ofru edhe i ka thënë njerëzve 'ejani me mu, se ju
2 pështoj.'"

3 Desha t'ju bëj këtë pyetje, kur UÇK-ja ju akuzoi se ishit
4 bashkëpunëtor, a ju ka akuzu edhe që po krijonit ndarje në
5 fshat?

6 PË. Po, kanë fol, por jo direkt mu. S'ka mujt askush me m'i
7 thanë, por kishin fol kështu, dhe në rrethit, grupit tem i
8 kishin fol, "Haxhia është tu bo grupacione". Por ndoshta që
9 edhe kam bo grupacione, sepse unë i kam këqyr me i mbrojt, jo
10 me i çu viktimë me i bo. Kjo i bjen, kjo është dallimi midis
11 meje dhe atij që është kanë.

12 PY. UÇK-ja, a po ju akuzonte si bashkëpunëtor edhe për faktin
13 se ishit shumë i afërt me serbët?

14 PË. Po në një aspekt, po. Por dhe ma së shumti se unë s'i kam
15 përkrah në aksionet kur kanë marrë, që kanë bo gabime fatale.
16 Krejt komplet kur i shifshin veprimet e mia që është, ishte
17 dallimi si nata me ditën. Veprimi jem me të tijnve. Se si
18 ushtar i parë kam qenë unë në fshat që e kam marrë pushkën që
19 i kam organizu, që i kam çu në Shqipëri rinia, domethënë
20 shokët, apo kojshijtë, apo katunarët apo --.

21 Por këtu ka qenë që sa ma shumë që thojshin që
22 bashkëpunëtor, tradhtar, spiun, me ju hi nder familjen e
23 tijnve, ose nderkom atijnve që ata me të shantazhu. Unë s'e
24 kam pranë atë. Unë e kisha pranë në arkivol me hi, a jo me hi
25 në atë formë ashtu, them. Kurse UÇK, kam qenë unë UÇK, ama i

1 vërteti, jo fallci.

2 PY. Pra, këto gjana që janë shkru këtu në këtë faqe, a
3 përputhen me ato gjana që ju kanë thanë ju në korrik të vitit
4 1998 UÇK-ja?

5 PË. Po.

6 PY. Nji sqarim përpara se të kalojmë te diçka tjetër. Është
7 në krye të faqes së transkriptit. Ti the që:

8 "... unë desha vetëm me i mbrojt ato dhe mos t'i bëja
9 viktima. Dhe kjo, ky është dallimi midis meje dhe atij."

10 Kur thu "atij", për e ke fjalën?

11 PË. Për ata persona që i kanë thanë vedit UÇK, megjithëse për
12 mu ata thua j as kanë qenë UÇK. Për mu. Se grup, gjithë UÇK-ja
13 ka qenë dy grupe. Edhe për këtë jua spjegoj pak ma vonë
14 ndoshta, doni, ose tash, kur të doni.

15 PY. Po, vazhdo.

16 PË. Ndëgjo, kur thuhet UÇK, na si me thanë kemi qenë çobanë.
17 Vetëm dallimi midis neve dhe çobanit është pushka edhe shtaga.
18 Çobani e ka shtagën për me rujt bagëtitë, kurse na e kemi pas
19 armën për me i mbrojt civilët. Por këtu ka qenë ai far dallimi
20 që çobani i keq i ka çu dhentë te gropat e ukit, thjesht shumë
21 du me e tregu, për me e tregu. Te gropat e ukit, e unë s'kam
22 lanë me i çu te gropat e ukit. I kam thanë, jo, jo, kjo është
23 e papranueshme për mu. Atëherë unë jam qu i padëshirushëm për
24 ta dhe tradhtar për ta, ose bashkëpunëtor për ta.

25 Bashkëpunëtor i Serbisë, demek. Kurse në realitet kjo i ka ra

1 kështu, i ka ra thjesht, po e flasim ne.

2 Sikurse një vajzë e pamartume po i thotë nanës së vet,
3 "Nanë, nama djalin", t'i them filanes, "ku është se s'më ka
4 thanë ajo mu". Kjo është matematike shumë e thjeshtë. Edhe t'u
5 i them, mor zotëri, unë po du me i mbrojt fshatin, këta mu po
6 më quajn bashkëpunëtor. Kofshi që jam bashkëpunëtor, do ta
7 mbroj fshatin, të jem bashkëpunëtor të dal haptas që jam
8 bashkëpunëtor. Kjo ka qenë për mu esenca për me, që kam ardh
9 unë sot për me dëshmu këtu. Se kjo është akuzë shumë e randë,
10 por unë atë nuk e shtijsha në kry, por rrezik të gjithë të
11 mëdhaja kam pas shumë. Raprezalje të madhe e kam pas shumë.
12 Shumë. Për këtë bilahin, s'di qysh jam sot këtu.

13 PY. Faleminderit, e kuptoj.

14 PË. Fshatarët serbë në Opterushë, a u akuzuan edhe ato në
15 mënyrë të rreme si bashkëpunëtorë prej UÇK-së?

16 PY. Po tash këtu që i kanë sulmu, aty diçka ka pas. Unë nuk
17 di ma tutje.

18 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund t'i
19 bëjmë pyetje dëshmitarit për paragrafin 17, në shënimin
20 përgatitor.

21 PY. Në këtë shënim përgatitor, ju javën që kaloi ju thatë që:

22 "Fshatarët serbë në Opterushë edhe ato u akuzuan në
23 mënyrë të rreme që ishin bashkëpunëtorë. Ata ishin vetëm
24 civilë."

25 Domethënë, duke pas parasysh këtë përgjigje që sapo na

1 dhatë tash, ajo që lexova tani, që sapo lexova a është

2 korrekte? A është e saktë?

3 PË. Po, de. Ashtu i bjen.

4 PY. A ke dijeni për ndonjë arsye legjitime pse u sulmuan ata
5 njerëz?

6 PË. Vallahi, me pas qenë ombrellën e [E pakuptueshme], flas
7 të UÇK-së, për shembull, ose me marrë komandë prej dikujt,
8 ndoshta e kisha ditë, por unë jam shku nga ato anë me mish e
9 me shpirt, me mbrojt që e kam cek me një vend aty në odë, të
10 një fshatit, të një fshatari tonë, që "në kjoftë nevoja edhe
11 qenin e fshatit duhet me e mbrojt, se leje ma shqiptar, serb
12 ose rom, edhe qenin e fshatit duhet e me mbrojt." Ju lutem.

13 PY. Thjesht përqendrohuni tek pyetja ime. Mund t'i
14 përgjigjeni me "po" ose "jo". A keni dijeni për ndonjë arsye
15 legjitime pse u sulmun serbët e Opterushës?

16 PË. Vetëm pse ishin serbë, asgjë tjetër.

17 PY. Në deklaratën tënde, ke thënë që i ke pa në traktor duke
18 e lëshu fshatin. Kjo ka qenë ditën mbas sulmit që e ke pa?

19 PË. Kjo ka qenë me si atë natë që i kanë sulmu, të nesërit
20 tani kur kanë marrë për me i tërhjek prej shtëpisë së vet për
21 me i çu për në fshatin Semetishtë. Edhe kanë ra prej skaj të
22 shtëpisë teme, kanë ra, unë veç isha në shtëpi teme. Për
23 dritares të shtëpisë, se shtëpinë e kam pas me gjithë bodrum
24 katërkatëshe, shtëpi të madhe, edhe e kam pa, thashë, tmerri i
25 botës.

1 PY. Nga ajo që ke mund me pa dhe me dëgju, a kishte ndonjë
2 gjë që të bonte me kuptu se ata serbët në atë traktor ishin
3 rrehë?

4 PË. Jashtë kam dëgju që kjaajshin. Dhe me këtë kanë kjaajt,
5 kanë qajt, qysh me e thanë. Kurse këtu te ne kanë shprehë edhe
6 të tjerët që i kanë pa, "po, po, i kemi pa tuj kjaajtë". Këta
7 të mbulum me batanije, kurse ushtria tu i çu për Semetishtë.

8 Unë këtë sulmin e Opterushës s'e kam qujt, nuk është kanë
9 sulmi serb për serb, por sulmi për komplet Opterushën është
10 kanë. Se komplet 2700-2800 banorë janë kanë aty. Kjo është,
11 kjo është kanë e papranueshme. Këto, e q'ajo më ka kushtu mu
12 shumë, se unë këtë e kam cek qysh herët, në EULEX unë kam pas
13 punë.

14 PY. Ju thatë që ata ishin duke qarë. A bënte me kuptu ajo,
15 kishte ndonjë diçka që bënte me kuptu se i kishin rrahë?

16 PË. Po ata janë, ose nga frika ose nga rrahmja, ata me u kanë
17 të disponueshëm kishin kjeshë, por ose nga frika ose nga
18 rrahmja. Kjo ka qenë.

19 PY. Dëshmitar, ka nja dy raporte që dua t'ju tregoj në lidhje
20 me këtë sulm mbi, kundër serbëve të Opterushës.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe i nderuar Gjykatës, po shoh
22 orën. Do të kemi pushim në orën 15.30?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, vazhdoni.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, a mund të vendosim në
25 ekran IT-05-87 5D01011, si në gjuhën origjinale ashtu dhe në

1 anglisht.

2 PY. Dëshmitar, asnjë prej këtyne nuk është në gjuhën shqipe.

3 Por një pjesë e këtij raporti ushtarak serb ta kemi lexu gjatë
4 përgatitjes. Dhe unë desha të bëj nja dy pyetje për nja dy
5 pjesë të këtij raporti.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Po të shkoni pak më poshtë,
7 ndaloni këtu në anglisht, është e saktë.

8 PY. Dhe thotë:

9 "Midis orës 19.00 të mbrëmjes dhe 22.00 të mbrëmjes me 17
10 korrik 1998, terroristët shqiptarë bënë një sulm kundër
11 fshatit ...", jo, "... në aksin Zoqishtë-Opterushë. Nuk ka të
12 dhëna për pasojat."

13 A ka, a përputhet kjo me atë, me datën dhe me orën kur u
14 sulmua Opterusha, kur ndodhi ajo, sulmi i Opterushës?

15 PË. Do, ora 16.00, a po?

16 PY. Jo, raporti mes orës 19.00 të mbrëmjes deri në orën 22.00
17 të mbrëmjes. Pra, ora 19.00 e mbrëmjes dhe 20.00 e mbrëmjes. A
18 përputhet kjo?

19 PË. E unë e di pak ma herët ka qenë, por ndoshta -- se unë e
20 di pak ma herët ka qenë kjo kohë. Se në qatë natë -- a ta
21 spjegoj këtë, këtë rast?

22 PY. Kur thoni ka qenë pak më herët -- e fillojmë kështu më
23 mirë. Ti mendon që sulmi ka filluar para orës 19.00 të
24 mbrëmjes?

25 PË. Po.

1 PY. Sulmi vazhdoi përgjatë natës?

2 PË. Sulmi -- jo drejt në familjen e serbëve, por sulm ka qenë
3 demek në orën, në mes Zoqishtit dhe Opterushës, domethënë
4 gjoja që po vijnë forcat serbe, njifarë propagande ka qenë,
5 njifarë loje aty.

6 PY. Sulmi, pasi filloi, zgjati gjatë natës?

7 PË. Po. Sulmi, po, ka zgjat.

8 PY. Thotë, më poshtë raporti si në vijim:

9 "Ka të ngjarë që në operacionet që janë kryer deri tani
10 terroristët kanë rrëmbyer 16 serbë të Rahovecit."

11 Ju sapo thatë që keni parë UÇK-në që i mori serbët me
12 traktor ditën pas sulmit, kështu?

13 PË. Po, por nuk e di se sa kanë qenë, as qysh, nuk kam
14 njohuri me numra se sa.

15 PY. Dhe në fillim kur u prezantove, ti e the, por Opterusha a
16 është pjesë e Rahovecit?

17 PË. Opterusha është pjesë e komunës të Rahovecit, po, pjesë e
18 Rahovecit.

19 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ky raport ka
20 datë, nënshkrim, vulë. Dëshmitari i dha dhe kontekstin
21 përkatës. Do kërkonim që të pranohej në anglisht dhe versioni
22 origjinal në serbisht.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
24 kundërshtime?

25 Z. DIXON: [Përkthim] Po, kemi kundërshtime. Nuk mendojmë

1 që është vendosur në kontekst. Dëshmitari thotë që sulmi ka
2 filluar më herët. Kështu që Prokurori thjesht i tha, ah ka
3 filluar më herët, por nuk e përcaktoi se sa më herët kishte
4 filluar sulmi.

5 Sigurisht që dëshmitari ka të drejtë të japë dëshmi për
6 atë që i kujtohet, por nuk mund të merret për bazë dëshmia e
7 këtij dëshmitari për dokumentin në fjalë. Veçanërisht që
8 Prokuroria ka pasur plot dëshmi nga personat që kanë qenë
9 përkatësisht të përfshirë nga pala serbe, dhe ata mund ta
10 japin dëshminë lidhur me këtë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është i qartë
12 nga raporti që po flasim për të njëjtat ngjarje që po flet
13 dëshmitari.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka gjë
15 tjetër? Atëherë, me sa shoh nuk ka kundërshtime të
16 mëtutjeshme.

17 Trupi Gjykses do ta pranojë dokumentin me numër IT-05-83
18 në anglisht edhe në serbisht.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 materiali do të marrë numrin P01809, dhe klasifikimi është
21 konfidencial.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si dokument
23 publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
25 Riklasifikojeni.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, flasim tani për traktorin që ke parë ti një
4 ditë pas sulmit. Në deklaratën tënde ti ke thënë që Florim
5 Zaza është personi që po e ngiste, po e drejtonte, voziste
6 traktorin, kështu?

7 PË. Po, Florim Mamaj, Florim Zaca. Zaca i thojnë, si
8 pseudonim e ka.

9 PY. Po ashtu ke thënë, në materialin P1807, në përforcimet që
10 ne kemi parë, sulmit, atë natën e sulmit, ndër të tjera vinin
11 nga Drenoci dhe Sametishta, kështu? Semetishta.

12 PË. Po. Ana e Suharekës, faktikisht. Semetishta i thonë.
13 Dobërdolan, Samadrexhë, të gjitha ato fshatrat.

14 PY. Florim Mamaj, a Zaca, është i njëjti Florim Zaca që mori
15 armën tënde dhe të dy të njohurve të tu pas sulmit ndaj
16 serbëve në fshat?

17 PË. Po.

18 PY. Edhe një herë për referencë, bëhet fjalë për materialin
19 me numër P1807, paragrafi 34. Tani, komandanti i këtij
20 Florimit ka qenë Feim Balla?

21 PË. Feim Balaj edhe Ismet Bylykbashi, këtë kanë qenë që ma
22 kanë marrë armën mu.

23 PY. Po sipas teje, kush ishte komandanti i Florim Mamajt,
24 Feim Balajt, kush ishte komandanti, si e kuptove ti?

25 PË. Po mu ma merrke mendja ma fort që ky Feimi, Feim Balaj.

1 PY. Dëshmitar, dua të tregoj një pjesë të një blloku
2 shënimesh tani.

3 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës, të
4 vendosë në ekran materialin 0189-2905, 0189-2914, dhe në
5 anglisht edhe në shqip. Shënimi përkatës që na intereson është
6 në numrin 0189-2912.

7 PY. Dëshmitar, e shikon shqipen në të majtë të ekranit? Këtë
8 nuk e kishe parë ndonjëherë përpara se t'ua tregoja unë javën
9 e kaluar, apo jo?

10 PË. Jo.

11 PY. Nuk do ta lexoj të gjithë, por do fokusohem në disa
12 pjesë. Thotë kështu: "Opferushë, 17 korrik 1998", në titull,
13 dhe thotë:

14 "Më 17 korrik 1998, rreth orës 18.00 të pasdites, filloi
15 sulmi ..."

16 A përputhet kjo me datën dhe me orën që ju kujtohet ju
17 kur ka filluar ky sulmi në Opferushë?

18 PË. Po. Po, po, si rasti më kujtohet, si ngjarje.

19 PY. Thotë, më poshtë:

20 "... janë përdorur vetëm armë personale, pushkë dhe
21 granata."

22 Pra, me sa ju kujtohet ju, ose me sa keni dëgjuar, vetëm
23 armë të vogla janë përdorur në këtë sulm?

24 PË. Po.

25 PY. Po ashtu thotë:

1 "Disa civilë, prej civilëve që i morën forcat tona u
2 liruan më pas dhe nuk u bë asgjë kundër tyre. Të tjerët janë
3 liruar [Sipas përkthimit] si të burgosur lufte."

4 Dhe vazhdon në faqen tjetër teksti.

5 Dëshmitar, me sa kam kuptuar unë, ju keni parë që në
6 traktor, pra nga sa patë ju, nga personat që patë në traktor,
7 domethënë, disa persona i morën me traktor, por disa i mbajtën
8 pas sulmit, kështu?

9 PË. Q'ashtu kem dëgju.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër tek
11 anglishtja, ju lutem, që është me numër 2913.

12 PY. Dhe thuhet:

13 "Pjesëmarrja në këto veprimtari, në këtë veprimtari ka
14 marrë pjesë Kompania 3, Kompania 1 dhe anëtarë të Kompanive të
15 tjera të batalionit 1, dhe anëtarë të policisë ushtarake, të
16 gjithë vinin nga shtabi lokal i UÇK-së i Suharekës.

17 "Oficer Isuf Krasniqi e drejtonte operacionin."

18 Pra, ju po thoni që këta erdhën nga Suhareka, kështu?

19 PË. Po. Por, për Isufa -- si e pat emrin ai? Krasniqi? Unë
20 atë nuk e njof, këtë person.

21 PY. E kuptoj. Shkojmë në faqen tjetër, tek anglishtja, në
22 faqen me numër 2912. Ku thuhet që sulmi është bërë "ndaj disa
23 forcave serbe paramilitare të vendosura në këtë fshat."

24 Dëshmitar, ka pasur forca paramilitare serbe në Opterushë
25 ditën e sulmit?

1 PË. Jo.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të doja të vendosej në
3 ekran materiali me numër P1333, që përndryshe ka ERN 083227
4 deri në 083239 RED2, në anglisht edhe në shqip, më konkretisht
5 faqen 083228 në të dyja gjuhët.

6 PY. Dëshmitar, që t'ju orientojmë ndërkohë që presim të dali
7 dokumenti në ekran. Kjo është një provë që është pranuar si
8 pjesë e provave gjyqësore në këtë çështje, dhe është një
9 historik i Brigadës 123. Kam nja dy pyetje për këtë faqen
10 konkrete që do të shfaqet në ekran.

11 Së pari, të shkojmë drejt fundit të faqes. Këtu flitet
12 për mënyrën se si batalioni 1 kishte tre kompani, ishte ndarë
13 në tre kompania. Dhe thotë ku janë kompanitë dhe kush ish
14 përgjegjës, dhe këtu thotë, Kompania 3 ka qenë aktive në
15 Samedraxhë, Dobërdolan, komandanti ishte Feim Balaj. A bëhet
16 fjalë për të njëjtin Feim Balaj që përmende pak më përpara në
17 dëshmi?

18 PË. Po, ky i Dobërdolani është, ama tash a ka qenë i komplet
19 shtabit të Dobërdolanit, nuk kam njohuri, nuk e di.

20 PY. Thotë:

21 "Kompania 3 ..."

22 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë pak më lart në faqe.

23 PY. Ju thatë që nuk e keni njohur këtë personin, por shihni
24 që Isuf Krasniqi këtu është ndihmës komandanti për policinë
25 ushtarake.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
2 pranimin e bllokut të shënimit që i treguam dëshmitarit i cili
3 mban numrin ERN 0189-2905, 0189-2914 ky është një dokument që
4 është gjetur fillimisht nga autoritetet serbe. Ka informacione
5 të mbështetshme për operacionet e UÇK-së në zonën e Rahovecit,
6 të cilat i ka vendosur në kontekst dhe ky dëshmitar. Ky
7 dëshmitar ka në fakt rreth dhjetë faqe madje dhe më pak sepse
8 disa prej këtyre faqeve janë përkthime.

9 Kërkojmë pranimin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtime?

12 Z. DIXON: [Përkthim] E kundërshtojmë. Ne nuk e dimë kush
13 është autori i këtij blloku shënimesh. Ky dëshmitar sigurisht
14 që nuk na ndihmoi dot lidhur me këtë. Mënyra se si e bëri
15 pyetjen Prokuroria, s'kishte kuptim sepse mund t'i vendosësh
16 një copë letre një dëshmitari, mjaft që dëshmitari të
17 identifikojë në vija të përgjithshme diçka.

18 Dëshmitari nuk e identifikoi asgjë, duhet të, ai foli
19 përgjithësisht për diçka që i kishte ndodhur dhe duhet
20 vendosur kufiri këtu. Sepse përndryshe dëshmitarët mund të
21 flasin, por nuk ka pasur lidhje të drejtpërdrejtë me ngjarjen
22 në fjalë.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk më pëlqen mënyra se si po
24 orienton Prokurori këtë dëshmitar. Dëshmitari është i qartë
25 për personat që mund të identifikojë, kë ka identifikuar si

1 persona pjesëmarrës në sulm, edhe tani Prokurori po përpigjet
2 që ta orientojë në një drejtim të caktuar.

3 Unë mund të jap hollësi të mëtutjeshme, por nuk e di a
4 mund ta bëj këtë në praninë e dëshmitarit. Apo mbase ju po e
5 kuptoni se ku dua të dal unë.

6 Por është e qartë. Ai nuk i njeh personat që kanë qenë në
7 atë sulm, ka njohur vetëm një person dëshmitari. Thotë vetë se
8 nga vjen. Ka njohur theksin e disave. Që burrat kanë maska,
9 dhe kaq. Tani po shohim dokumente për Brigadën 123, ky
10 dëshmitar s'e ka përmendur fare këtë brigadë gjatë dëshmive të
11 tij. Dhe nuk më pëlqen fakti që po orientohet dëshmitari që të
12 dalë në disa përfundime të cilat ai vetë nuk i ka dhënë
13 shprehimisht. Kemi hyrë në shtigje të parrahura këtu.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohemi.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari po jep një pjesë të
16 dëshmisë së tij dhe ne po përpigemi të kuptojmë se si mund të
17 na ndihmojë dëshmitari të formojë mozaikun e plotë, apo
18 panoramën e plotë të kësaj dëshmie.

19 Dëshmitari ka folur për periudhën kohore e cila
20 përputhet, armët që janë përdorur, personat që janë marrë,
21 edhe që ka qenë shtabi i Suharekës. Edhe për faktin e
22 paramilitarëve, paraushtarakëve, është një fakt tregues
23 autenticiteti sepse ne mendojmë që UÇK-ja në fakt ka shkruar
24 veçanërisht për këtë pjesë.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Ai po jep një dëshmi, çfarë është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Haxhi Mazreku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 120

1 autentike këtu? Nuk e kuptoj dot, për mua është e papranueshme
2 që të mendohet që është autentik ky dokument thjesht se po jep
3 dëshmi dëshmitari.

4 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
6 do ta pranojë dokumentin, i është dhënë konteksti i
7 mjaftueshëm këtij dokumenti. Prandaj, dokumenti me numër 0189-
8 2905, 0189-2914 pranohet.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
10 numrin e provës P01810, aktualisht i klasifikuar si
11 konfidencial.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni,
13 0180? 01810, më falni.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po. Dhe një herë po e
15 lexoj. P01810.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Dëshmitar, do të doja të qëndronim shkurtimisht te kjo
18 faqe për të folur për Brigadën 123. Ju keni përmendur Blerim
19 Kuqin dhe Ilaz Kadollin gjatë dëshmive tuaja. E njihni
20 personin ju, Habib Elshani që është përmendur këtu si zëvendës
21 -- si komandanti i brigadës, zëvendëskomandanti i brigadës, më
22 falni. Habib Elshani, e njihni?

23 PË. Po.

24 PY. A ka qenë ai komandant në zonën e Suharekës?

25 PË. Në Suharekë nuk di se çka ka qenë, por ndërmjet shtabit të

1 Dobërdolanit kur jam shku që i kam organizu për me shku me
2 marrë armatim në Shqipëri, kam shku ndërmjet tij. Tash se
3 çfarë roli ka pas, nuk e di. Por ndërmjet tij jam shku për me
4 marrë armë në Shqipëri.

5 PY. Pse shkove në Dobërdolan për të marrë ndihmë logjistike
6 për këtë udhëtim për Shqipëri?

7 PË. Po shkova se e kemi pak si ma afër aty, se çdo rrugë pak
8 ma e gjatë që ka qenë, është kanë pak me rrezik, a po më
9 kupton. Domethënë, kam këqyr veç ku është më afër, me bisedu,
10 me këqyrë çka, me dal prej situatës së ligë. Me lypë mbrojtje,
11 thjesht.

12 PY. Kur krijuat njësitin tuaj të UÇK-së ju, e regjistruat në
13 ndonjë vend?

14 PË. Po.

15 PY. Ku?

16 PË. Po një herë e kam regjistru me një fletore në shtëpi
17 teme, ose në shtabin tem, tani kam shku për në Dobërdolan, e
18 kemi regjistru.

19 PY. Pra, e kuptova drejt unë që njësitin jua ka qenë nën
20 zonën e përgjegjësisë së Dobërdolanit?

21 PË. Si afërsisht, po. Por jo komanda që kam marrë prej tij.
22 Prej tijne s'kam marrë komanda. Veç e kam këqyr, kam me bo
23 zgjidhje me dalë te armatimi, me marrë armatim, për me mbrojt
24 fshatin. A komandë prej kurrkujt s'kam marrë.

25 PY. Në rregull. Por kur ju duhej për shembull ju ndihmë,

1 Habib Elshani ishte ai që ju ndihmoi ju, pra njësitin tuaj, që
2 të merrnit armë nga Shqipëria. A e kam kuptuar mirë unë?

3 PË. Po.

4 PY. Të flasim për Ilaz Kadollin tani. Është ende në ekran
5 këtu. Kur keni parë atë në Semetishtë ai nuk tha ndonjë gjë
6 për çështjen e zbulimit, por a u identifikua ai ju si një
7 komandant?

8 PË. Po.

9 PY. Dua t'ju bëj një pyetje për një pjesë konkrete të
10 intervistës që keni dhënë për Prokurorinë këtu.

11 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës të
12 vendosë në ekran materialin me numër P01805.4, në fund të
13 faqes 6, dhe në anglisht edhe në shqip. Kalon edhe tek faqja
14 7.

15 PY. Dëshmitar, kjo është një pjesë e intervistës për ZPS-në,
16 ku përmendet Semetishta. Kur të shfaqet në ekran, do t'ju
17 lexoj një pjesë dhe pastaj do t'ju bëj disa pyetje lidhur me
18 të.

19 Ju kanë bërë këtë pyetje:

20 "PY. Keni qenë me pranga, t'i kanë lidh duart, si të
21 kanë transportuar?"

22 Jeni përgjigjur:

23 "Jo. Po kur kam shku në Semetishtë gjatë bisedës aty, tu
24 bisedu filloi kërcënimi. Aty ma ka bë, 'A e dish ti që i ki
25 katunarët e tu këtu te na' e kishte fjalën për serbët. 'A e di

1 që bashkëfshatarët janë këtu, po këtu të njëjtit fat edhe ty'
2 -- 'i njëjti fat do të presë edhe ty.'"

3 Dëshmitar, kush t'i ka thënë ty këto?

4 PË. Ky Ilaz Kadolli këto fjalë m'i ka thanë. Ka pas kërcënime
5 por unë ato s'i kam marrë për bazë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Tani, i lutem Sekretarit të
7 seancës të vendosë në ekran materialin -- 507924 [Sipas
8 përkthimit] deri 058024, dhe është faqja 058008 në anglisht
9 dhe në shqip.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kam një kundërshtim, para se ta
11 bëj këtë Sekretari i seancës. Dhe do të doja ta bëja
12 kundërshtimin pa praninë e dëshmitarit. Nëse ka lidhje me
13 Shënimin Përgatitor nr. 2, paragrafi 5.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po, me atë ka lidhje.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë do të doja të bëja një
16 parashtrim pa praninë e dëshmitarit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shoqërojeni
18 dëshmitarin për të dalë nga salla.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,
21 znj. Tavakoli.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

23 Paragrafi 5 i Shënimit Përgatitor 2 thotë:

24 "Ajo që Ilaz Kadolli i ka thënë dëshmitarit për serbët e
25 Opterushës që ishin tek vendi i tij", jepet dhe referenca,

1 "dhe kjo është në përputhje me atë që shkruan Ilaz Kadolli për
2 njësitin e tij, për ndihmën e Oploterushës në këtë -- domethënë,
3 për faktin që njësiti i tij i Zoqishtës dhe i Oploterushës në
4 këtë faqe."

5 Tani, i kthehem intervistës së dëshmitarit, Pjesa 4,
6 faqja 7. Ajo që ka thënë Ilaz Kadolli është kjo, që i ka thënë
7 dëshmitarit që serbët dhe bashkëfshatarët janë bashkë me të në
8 Semetishtë. Ky informacion nuk gjendet fare në faqen që do të
9 vendosi dëshmitari -- më falni, Prokurori në ekran dhe t'ia
10 tregojë dëshmitarit. Por kjo është e qartë pse po e bën këtë
11 Prokurori, sepse në atë faqe është një fjali e Ilaz Kadollit
12 që thotë, "Shtabi i Përgjithshëm kërkoi Brigadës 123 të ...
13 /?ndihmonte/ ... Zoqishtën dhe Oploterushën. Ushtarët shkuan dhe
14 u bënë pjesë e sulmit", e me radhë.

15 Pra, është e qartë nga ky seksion që është e njëjta gjë,
16 po thuhet e njëjta gjë. Dhe ky ishte kundërshtimi im. Nuk
17 është dëshmi e këtij dëshmitari, por ky dëshmitar po përdoret
18 që të thojë gjërat që kërkon Prokurori. Ai e njeh, ne e kemi
19 Ilaz Kadollin dhe mund t'i bëjmë, pyesim Ilaz Kadollin se
20 çfarë ka ndodhur. Por nuk mund t'i tregohen këtij dëshmitari
21 faqe të librit të Ilaz Kadollit që nuk kanë kurrfarë relevance
22 me dëshminë e këtij dëshmitari.

23 Prandaj, për këtë arsye, nuk mendoj që duhet t'i tregohet
24 dëshmitarit kjo pjesë, edhe mund të bëhet kërkesa, dhe kur të
25 bëhet, dhe madje kur të bëhet kërkesa për këtë, ajo kërkesë

1 duhet të rrëzohet. Nuk është relevante për dëshminë e këtij
2 dëshmitari, është e pambështetur me prova, është cenuese dhe
3 tejkalon vlerën provuese.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Tavakoli, por ju të
5 njëjtit qëndrim do të kishit ju nëse ky dokument do të ofrohej
6 përmes mocionit të dëshmive jogojore si pjesë e një libri?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Problemi është që ky libri ka
8 qenë objekt i një mocioni për dëshmi jogojore, disa pjesë të
9 këtij libri. Dhe mendoj që fillimisht ZPS-ja u kërkoi një herë
10 të pranohej i gjithë libri, në tërësinë e vet. Kjo u rrëzua.
11 Dhe besoj se ju, të nderuar Gjykatës, vendosët që Prokuroria
12 do të duhet të kërkonte pranimin faqe për faqe, në mënyrë që
13 të pranoheshin faqet përkatëse.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po kjo ka të, po kjo ka
15 lidhje me relevancën. Po unë po ju them, nëse kjo faqe do të
16 ofrohej përmes një mocioni të dëshmive jogojore, çfarë do të
17 bënit ju?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Por është ofruar dhe është
19 rrëzuar. Tani Prokuroria po përpiqet ta pranojë përmes këtij
20 dëshmitari. Unë po ju them që nuk plotëson standardin sepse
21 nuk është dëshmi e këtij dëshmitari.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju po thoni që një
23 material të jetë i pranueshëm, duhet të jetë relevant me
24 dëshminë e dëshmitarit? Nuk duhet të jetë relevant për
25 çështjen gjyqësore? Se nuk po ju kuptoj unë.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani unë e kam kuptuar kështu:
2 Prokuroria ka kërkuar që të pranohet i tërë libri. Trupi
3 Gjykues e rrëzoi.

4 Kështu që pyetja juaj dhe kërkesa juaj, ju po më thoni
5 tani, a mund ta pranojmë këtë përmes një mocioni jогоjor? E ka
6 bërë Prokuroria këtë dhe ju e keni rrëzuar. Tani kemi një
7 standard tjetër dhe kemi standardin sipas rregullës 138. Dhe
8 për arsyet që sapo citova më herët, që sapo ceka, unë po them
9 që nuk përmbushet standardi përkatës. Ose ju po thoni tani që
10 vendimi që kishit marrë ju më përpara ka qenë i gabuar, dhe
11 duhet ta kishit pranuar qysh në fillim këtë libër.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni të drejtë për këtë.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbështesim dhe
14 ne të njëjtin kundërshtim. Nuk mund të pranohet përmes një
15 mocioni jогоjor.

16 Qëndrimi ynë është -- madje është mirë që ta nxjerrim
17 faqen në ekran -- është të pranohet përmes dëshmitarit
18 përkatës. Ky dëshmitar s'ka lidhje fare me këtë pjesë. Edhe
19 mendoj që duhet të rrëzohet.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] I bashkohemi dhe ne kundërshtimit.
21 Shkurtimisht qëndrimi ynë është që duhet të rrëzohet kjo
22 kërkesë për shkak të efektit cenues që ka ky, kjo gjë nëse
23 pranohet në këto momente, dhe për shkak se tejkalon vlerën
24 provuese. Të kërkojsh të pranohet një fjali e një libri që
25 thuhet diçka për Shtabi i Përgjithshëm, është diçka që ne nuk

1 mund ta përdorim kur të bëjmë kundërpyetjet tona me këtë
2 dëshmitar.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Unë habitem që po thoni ju s'paska
4 lidhje kjo fjali me dëshminë e këtij dëshmitari, po më lini pa
5 fjalë. Dëshmitari po tregon çfarë i ka thënë Ilaz Kadolli, po
6 na thotë informacione që aludojnë se njësitë i Ilaz Kadollit
7 ka pas serbët e Optrushës dhe në këtë faqe të librit thuhet
8 se është dhënë ndihmë në Optrushë dhe thuhet që Shtabi i
9 Përgjithshëm në dëshminë e këtij dëshmitari, pra dhe njëherë
10 dëshmia e këtij dëshmitari është që ka qenë atje natën e
11 sulmit dhe urdhri ka ardhur nga hierarkia nga lart.

12 Edhe që t'i përgjigjem unë Gjykatësit Mettraux, sepse nuk
13 u përgjigj znj. Tavakoli, nuk ka asnjë arsye legjitime për ta
14 kundërshtuar këtë material nëse pranohet përmes mocionit të
15 provave jogojore. Dhe mendoj që e kemi dëshmitarin e duhur
16 këtu për t'i dhënë kontekstin përkatës.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Është i pranueshëm sepse është relevant, ka vlerë
20 provuese dhe do të pranohet sipas rregullës 138(1).

21 Z. DIXON: [Përkthim] Po ende s'ia kemi treguar
22 dëshmitarit, faqen në fjalë për të cilën po diskutojmë ne ende
23 s'e ka parë dëshmitari.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 [Përkthim] Atëherë, faji im. Faji im, atëherë, ju kërkoj

1 ndjesë. [Mikrofoni çaktivizuar].

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë për t'ju
3 ndihmuar sa i takon parashikimit kohor, kjo është fusha e
4 fundit që do të mbuloj me pyetjet e mia.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Dëshmitar, do vazhdoj tani me pyetjet.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë i lutem fillimisht
9 Sekretarit të seancës të vendosë në ekran materialin 057924
10 deri në 058024, faqja 058008.

11 PY. Dëshmitar, sa për t'ju dhënë pak kontekst këtë, ky është
12 një faqe nga një libër që ka shkruar Ilaz Kadolli për luftën.
13 Edhe ju nuk e kishit parë ndonjëherë këto faqe përpara se sa
14 të bënim seancën përgatitore, a është kështu?

15 PË. Unë s'e kam pa. Hera e parë që e kam pa atë ditë.

16 PY. E kuptova. Në faqen, në shqip është në të majtë. Diku në
17 mes është një fjali që thotë që:

18 "Nga Shtabi i Përgjithshëm kërkohet që Brigada 23 [Sipas
19 përkthimit] ta ndiqte -- ta ndihmonte Zoqishtën dhe
20 Opterushën."

21 A ju, a ishte kjo që, a përputhet kjo me atë që të tha
22 Ilaz Kadolli në lidhje me serbët e Opterushës edhe pse ata
23 kishin shku tek shtëpia e tij, në fund të fundit?

24 PË. Po, po.

25 PY. Natën e sulmit, Ejup Kabashi tha që "urdhri ka ardh nga

1 nalt", dhe ti e pyete, "nga ka ardh?", a të ka dhënë përgjigje
2 ai se prej kah erdhi urdhri?

3 PË. Po. Më dha përgjigje tha, "urdhri ka ardh prej naltit".
4 Bile thash, "Ku prej naltit?". Kqyra, thashë "more çka je ka
5 ban ti", thashë. "Ndalu", thashë "se është e palejueshme". Por
6 i ka pas nja tre persona që s'i kam njoft ata persona, me
7 vete. Edhe ata me këmbëngulje që grupi jem me shku me iu
8 bashkangjit atyne, dhe me shku te shtëpitë e serbëve. Kjo ka
9 qenë.

10 PY. A të ka dhënë ndonjë informacion tjetër se kush ishin
11 këta njerëz prej së naltit?

12 PË. Jo. Jo.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Siç e diskutuam pak përpara, në
14 mungesë të pranisë së dëshmitarit, libri jep informacion se
15 kush ishin këta, si në dokumentin P1329.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimet
17 i kemi në procesverbal, kështu që, znj. Tavakoli në qoftë se
18 do të m'i përsërisni shkurtimisht çfarë thatë.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Unë desha të them se libri nuk
20 e jep përgjigjen, është një libër, është 300 faqe të mendimeve
21 të një personi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kjo këtë
23 mund ta trajtoni gjatë kundërpyetjeve tuaja.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Edhe disa pjesë të librit
25 faktikisht janë pranuar në provën P12.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky libër, kjo
2 faqe e këtij libri pranohet, dhe si provë është faqja 058008.

3 Kjo pranohet, kush ishte prova tjetër që është pranuar më
4 përpara?

5 Z. HALLING: [Përkthim] P12.

6 Z. DIXON: [Përkthim] A mund të ngre një çështje në lidhje
7 me përkthimet, të cilën do ta ngremë si problem dhe më vonë?
8 Sepse nuk është e qartë se çfarë fjale është përdor. Aty është
9 thënë për të "ndihmu", por ka, por "asistu", thuhet në
10 anglisht. Por ka dhe fjalë të tjera që janë përdorur aty që
11 nuk janë përkthyer dhe nuk është dhënë ndonjë shpjegim se pse
12 nuk janë përkthyer. Pra, duket sikur Prokuroria po i kushton,
13 po e thekson së tepërmi fjalën "asistoj", dhe kësaj faqeje,
14 duhet që të sqarohet kjo punë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
16 keni pyetje për përkthimin, këto mund të bëni, për këtë mund
17 të bëni kërkesë që të verifikohet.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Po unë kërkoj këtë përpara se sa të
19 pranohet si provë.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ky është përkthimi më i mirë që
21 kemi mundur të nxjerrim. Ne, por siç e thatë edhe ju, mund të
22 verifikohet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht, ne
24 jemi të hapur që ai të, përkthimi të verifikohet.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po të them këtë që në versionin

1 shqip duket sikur ka fjalë të cilat nuk mund të përkthehen dhe
2 duam të dimë nëse ka mungesa në përkthim apo s'ka mungesa në
3 përkthim, kjo duhet të verifikohet. Por, na duhet një shpjegim
4 i mëtejshëm dhe përpara se sa të pranohet, në mënyrë që të
5 trajtojmë këtë çështje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka ndonjë
7 shpjegim tjetër, me sa e dëgjova unë këtu.

8 Megjithatë, faleminderit që e sollët në vëmendjen tonë
9 këtë problem.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Vetëm për të konfirmuar këtë provë
11 materiale.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faqja 058008 do të
13 shtohet në provën P00012. Kjo faqe do të jetë konfidenciale
14 apo publike? Se libri është konfidencial.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Është publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të bëjmë një
17 pushim të shkurtër, dhe të përdorim pjesën e mbetur për
18 pyetjet e tjera.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ne si Prokurori nuk kemi më
20 pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
22 shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallës.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pesë
25 minuta pushim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Haxhi Mazreku (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 132

1 --- Seanca ndërpritet në orën 16.05

2 --- Seanca rifillon në orën 16.11

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Silleni ju
4 lutem Dëshmitarin në sallë të gjyqit.

5 Dëshironi t'i bëni pyetje dëshmitari?

6 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk do bëj pyetje.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni,
9 Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

12 Tavakoli, që përfaqëson Mbrojtjen e Thaçit ka disa pyetje për
13 të bërë.

14 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. Mirëdita, zotëri.

17 PË. Mirëdita.

18 PY. Ti e ke formu njësitin tënd të UÇK-së në fshatin tënd një
19 ose dy muj mbas incidentit Jashari, kështu?

20 PË. Ma herët. Domethënë, përnjëherë, jo një muaj por
21 menjëherit. Që ka ndodh rasti unë veç kam fillu tani me u
22 marrë me aktivitetin e --

23 Z. DIXON: [Përkthim] Më falni që po ndërpres, por po
24 presim klientin tonë që të vijë ta ndjeki seancën.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Veseli,

1 jeni aty?

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
3 këshillohen]

4 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë
6 jemi këtu tani.

7 Kështu që mund të vazhdoni me pyetjet.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

9 PY. A kam të drejtë kur them që grupi yt i UÇK-së u krijua
10 për shkak të nevojës për të mbrojtur veten, për të mbrojtur
11 fshatin dhe pronat tuaja si formë vetëmbrojtjeje?

12 PË. Po.

13 PY. Faleminderit. Pra, u krijua nga baza. E keni kriju në
14 nivelin e bazës. E keni kriju vetë ju?

15 PË. Na e kemi kriju vetë sepse Rugova non-stop thojke duhet
16 me e rujt pragun e shtëpisë, kështu që kam pas atë, gjithmonë
17 atë përshtypjen që duhet me mbrojt fshatin.

18 PY. Dhe ti e caktove veten tënde si komandant të grupit,
19 kështu?

20 PË. Unë i thirra, po mendoj, kushërinjtë e mi, e i thashë,
21 "Ç'ka do të bëjmë? Kush do të bohet, le të bohet. Ai, ky,
22 tjetri". Po s'pranoi kurrkush atëhere më mbet mu. S'e s'kam
23 pas qëllim për me qenë unë udhëheqësi i këtij grupit. Edhe
24 kështu mora unë tani pozitën.

25 PY. Pra, keni -- ratë dakord mes njëni-tjetrit për kte, nuk

1 ju ka caktu dikush prej nalt?

2 PË. Jo.

3 PY. Dhe nuk i ke raportu ndokujt, nuk ke dhënë llogari para
4 ndokujt ma nalt, apo jo?

5 PË. Jo, jo, absolutisht.

6 PY. Në verën e '98 i ke thënë Gjykatës që në Opterushë kishte
7 dy grupe të UÇK-së, një grupi yt, dhe grupi tjetër që ishte
8 udhëheqësi i të cilët ishte Ejup Kabashi?

9 PË. Po, e vërtetë.

10 PY. Grupi juaj nuk kishte marrëdhënie të mira me grupin e Ejup
11 Kabashit, a është kështu?

12 PË. Po na si familjarë kemi pas marrëdhënie të mira, po bisha
13 në kundërshtim me akcionet ose me vendimet ose me qëllimet e
14 tinve, une bijsha në kundërshtim. Nuk pajtohesha dhe u duh me
15 e mbajt grupin tem mos me ra viktimë e politikës e cila është
16 zhvillu, domethënë. [E pakuptueshme] politikë për mu ka qenë,
17 komplet konflikti në Kosovë.

18 PY. Ka pasur edhe mosmarrëveshje praktike siç i tregove zyrës
19 së Prokurorisë, për shembull, për vetura, për mjete, e kështu
20 me radhë?

21 PË. Po. Po.

22 PY. Dhe nuk jeni koordinu me ta?

23 PË. Jo.

24 PY. Pra, faktikisht, UÇK-ja që po operonte në Opterushë në
25 korrik 1998, nuk ishte e unifikime, nuk ishte vetëm një UÇK e

1 vetme, a është kështu?

2 PË. Mendoj se po. Ma herët ju ceka se qysh ka qenë. UÇK-ja ka
3 qenë sikur me thënë çobanët. Më duket e ceka pak ma herët, nuk
4 e di a mundet me u vërejt ajo që thashë. Një çoban ka qenë që
5 ka mbrojt, domethënë, vend. Të tjerët që ka këqyr me i çu te
6 gropat e ujçërve. E tash kush ka qenë në atë anë, nuk e di.
7 Por, kur e kam pa une vëzhgimet, punët, aktivitetin e tynve
8 unë jam kon, komplet jam kon i largum edhe jam kon i
9 dëshpërum. Kam thonë "kjo s'është në rregull kjo punë".

10 Domethënë, për akcionet ne flasim të fshatit Opterushë, sepse
11 ata kanë qenë katunarët tanë.

12 PY. Po, po.

13 PË. Edhe --

14 PY. Faleminderit, po. Ja ke dhënë këtë përgjigje Gjykatës.

15 PË. Edhe deshta, deshta edhe diçka me të shpjegu. Deshta
16 diçka me të shpjegu, nëse lejohet.

17 PY. Jo, unë i bëj pyetjen. Mund të kalojmë te diçka tjetër
18 tani, ju lutem.

19 PË. Faleminderit.

20 PY. E kam kohën të kufizume. Më vjen keq.

21 PË. Në rregull.

22 PY. Atëherë, Ejup Kabashi të ka thënë që kishte një urdhër
23 nga nalt, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe kur e ke pyt kush ishte, kush ishin këta nga nalt, ai

1 i ngrejti sytë nga qelli, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Ai nuk të tha se kush ja kishte dhënë atë urdhër?

4 PË. Jo, jo.

5 PY. As nuk të tha që ishte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së?

6 PË. Jo, nuk e ka përmend ato.

7 PY. Faleminderit. Tani dua të flasim pak për vetë sulmin. Ti

8 nuk i njifshe ata njerëzit që morën pjesë në sulmin e

9 Opterushës, përveç njenit, që e kishte emrin Florim?

10 PË. Për këtë Florimin e kanë fol tan masa, masanejna unë për

11 në atë natën kritike nuk e di. Po masanej që e kanë fol

12 Florim, po tuj i çu ata serbët për Semetishtë e kam pa atë

13 Florimin prej së largit. Ka pas 5-60 metra, 30 metra, ose

14 ndoshta ma tepër në distancë. Po të gjithëanej masanej e

15 folshin që Flrimi ka qenë vozitësi i traktorit që i ka çu në

16 Semetishtë, domethënë, serbët e Opterushës.

17 PY. E kuptoj, po Florimi është i vetmi person që e ke njoft,

18 kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Ti nuk e dije kush ishin ata burrat e tjerë?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse është e

22 megjullt pyetja. Ka pas -- a mund të sqarohet pyetja, se ka

23 pasur disa dëshmitarë të tjerë gjatë atij sulmi. A mund të

24 bëhet dhe një herë pyetja.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni edhe

1 një herë pyetjen.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

3 PY. A ka pas ndonjë burrë tjetër, një person tjetër përveç
4 Florimit që e ke njoft nga ajo ditë e sulmit si një
5 pjesëmarrës në atë sulm?

6 PË. Une jo, po që kanë fol tani masanej është diçka tjetër.
7 Ama une jo aty. Thojshin, thojshin që edhe Ismeti ka qenë,
8 Ismet Sorra, apo Ismet Bylykbashi.

9 PY. Kur thu "thoshin" ti vetë a e ke pa?

10 PË. Ismetin jo.

11 PY. Pra, të vetmin person që e ke pa dhe që e njifshe --

12 PË. Që e kam njoft.

13 PY. -- ishte Florimi?

14 PË. Po. Florimi.

15 PY. Po kështu i thatë Prokurorit, thjesht më konfirmoni atë
16 që thatë. Pra, ata e qujshin veten UÇK.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në procesverbal është P01805.2.

18 Faqe 36 deri në 37. Kjo është deklarata juaj, intervista me
19 ZPS-së.

20 PY. Pra, ju keni thënë "Ata e qunin veten UÇK, këta burrat që
21 sulmun fshatin, por mesa di unë ata nuk ishin. Për mu ata nuk
22 ishin UÇK". A është kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Pra, a kam të drejtë të them që këta burra po e abuzonin,
25 po e keqpërdornin emrin e UÇK-së?

1 PË. Unë ashtu mendoj.

2 PY. Faleminderit. Tani dua të kaloj tek lista e
3 bashkëpunëtorëve. Tre burra erdhën dhe të dhatë një listë të
4 bashkëpunëtorëve të pretenduar. A është e saktë që kjo listë
5 ishte shkrujt me shkrim dore dhe nuk ishte e nënshkume?

6 PË. Po, e saktë është.

7 PY. Dhe ti nuk e din se kush e ka shkrujt atë letër?

8 PË. Unë jo.

9 PY. Po kështu nuk e din -- nuk i njifshe ato tre burrat që ta
10 kanë dhënë listë?

11 PË. Jo, s'i kam njoft.

12 PY. Shumica e personave që janë atë listë, kështu i thatë
13 Prokurorit - është fjala për intervistën P01805.2, faqja 7
14 deri në 8 - shumë prej tyre përveç njenit që ishte mësus të
15 gjithë prej tyre ishin anëtarë të LDK-së, kështu?

16 PË. Po tash une nuk e kam majt evidencën sesa kanë qenë se [E
17 pakuptueshme] na thuje të gjithë kemi qenë LDK. Thuja. Po që
18 me thënë kisha ndonjë far posti, farë diçka, s'kam pas dijeni
19 në atë drejtim se unë jam marrë me zejtari, me punë teme. Nuk
20 e kam vëzhgu, s'i kam këqyr, s'i kam dit. Po ajo listë mu s'më
21 pëlqej, se ajo ka qenë --

22 PY. E kuptoj, e kuptoj këtë. Nuk po të pys a të pëlqeu lista,
23 por vetëm desha me të pyt a ishin shumica e njerëzve aty nga
24 UÇK-ja -- ah jo, më fal, LDK-ja. Dhe përgjigja juaj ishte
25 "po".

1 PË. Po.

2 PY. Po kështu i thatë Prokurorit që ju nuk mendonit që ata
3 ishin në atë listë sepse ishin anëtarë të LDK-së, nuk ishte
4 kjo arsyeja pse i kishin vu në shënjestër? Pra, është kështu?

5 PË. Arsyeja ç'ka kam mujt une me vrejti ka qenë që mu me më
6 shti në rrjedhën e tyre, me më shti mu me hi unë komandën e
7 tynve, thuja, dhe me qenë si bashkëpunëtor i tynve. Domethënë,
8 me më dirigju mue si komandant i asaj grupi, ata me më dhonë
9 koordinata. Po unë atë fare s'e kam hongër. Edhe kam rreziku
10 veten edhe ju kam thanë, "Largoju prej këtuhit se nuk është në
11 rregull kjo punë". Edhe tamam janë fillu sulmet ndaj meje.
12 Refuzimin kur e kam ba. Se s'po him --

13 PY. E kuptoj këtë, zotëri, po pyetja ime ishte pak ma
14 ndryshe. Dhe ndoshta më mirë ta lexoj nga ajo që keni thënë ju
15 në intervistë. Prokurori ju pyeti:

16 "A ishin vënë ata në shënjestër si kolaboratorë për shkak
17 të anëtarësisë së tyre në LDK?"

18 Dhe përgjigja juaj ishte:

19 "Jo, nuk besoj."

20 Këtë përgjigje jepni dhe sot? Kjo është dëshmia juj sot?

21 PË. Po.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
25 znj. Tavakoli.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi pyetje për këtë dëshmitar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të filloj tani në orën 4.28? Unë
4 ndoshta mund të mos ketë pyetje po më mirë të mendohem gjatë
5 natës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
7 sot mbaron dëshmia juaj në sallën e gjyqit. Do të vini nesër
8 në mëngjes përsëri. Do të mundohemi ta përfundojmë dëshminë
9 tuaj sa më shpejt nesër.

10 Faleminderit që keni ardhur këtu dhe ndihmuat Gjykatën.
11 Nuk mund të flisni me askënd. Nuk jeni i lejuar të flisni me
12 askënd në lidhje me dëshminë këtu në Gjykatë. Në qoftë se
13 dikush të pyet çfarë ke thënë në Gjykatë, ju lutem, na
14 informoni.

15 Shifemi nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

16 DËSHMITARI: Ju kuptoj. Faleminderit. Faleminderit.

17 Përshëndetje të gjithëve, respekt.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, nuk
20 të pyeta se sa -- ju do ta përdorni gjithë gjysmën e orës që
21 përmendët?

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk e di nëse do të përdor të gjithë
23 kohën, por kam disa pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
25 Sot mbaruam. Nesër në mëngjes në orën 9.00 do të mblidhemi

1 përsëri.

2 --- Seanca mbyllet në orën 16.28

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25